

VENDIM
Nr. 15, datë 11.3.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Marsida Xhaferllari	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji	anëtare e “ “
Altin Binaj	anëtar i “ “
Përparim Kalo	anëtar i “ “
Sonila Bejtja	anëtare e “ “
Elsa Toska	anëtare e “ “

me sekretare Belma Lleshi në datën 11.3.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 18 (S) 2018 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “BAVARIA” N.V.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale; shoqëria “ARSENI” sh.p.k.

OBJEKTI: shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 7121, datë 24.6.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1868, datë 6.5.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-2074(112), datë 5.10.2017, të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: nenet 16/2, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134 dhe 142, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, shoqërisë “Arseni” sh.p.k., i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, shoqëria “Bavaria” N.V., është shoqëri tregtare e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit holandez, e cila ka në pronësi markën tregtare B-52, pije energjike, pronësi e fituar nëpërmjet aplikimit në vendin e origjinës, në regjistrin e markave tregtare të Beneluksit, dhe regjistrimit të datës 22.2.2008, me nr. 838872. Ajo ka aplikuar, gjithashtu, për regjistrim ndërkombëtar në datën 20.6.2008 dhe marka tregtare B-52 është regjistruar përfundimisht në datën 24.6.2008, me nr. regjistrimi ndërkombëtar 970878.

2. Kërkuesja ka aplikuar për shtrirjen e efekteve të mbrojtjes së markës B-52 edhe në Shqipëri nëpërmjet aplikimit të datës 21.10.2008, ndërsa është regjistruar në datën 12.2.2009.

3. Subjekti i interesuar, shoqëria “Arseni” sh.p.k., është një shoqëri e së drejtës shqiptare, e cila është regjistruar si person juridik në datën 15.8.2006, me objekt kryesor të veprimtarisë së saj tregtare tregtimin me shumicë dhe pakicë të mallrave, kryesisht ato ushqimore, ndër të cilat, edhe pijen energjike B-52.

4. Ndërmjet shoqërive të lartpërmendura është zhvilluar një proces gjyqësor në lidhje me

markën B-52, me objekt padie: “Shfuqizimin e markës B-52 me nr. 970878, me pronar “Bavaria” N.V. Çregjistrimin e markës B-52 me nr. 970878 me pronar “Bavaria” N.V.” dhe objekt kundërpadie: “Shfuqizimin e markës tregtare B-52 me nr. regjistrimi kombëtar 11992, në pronësi të shoqërisë “Arseni” sh.p.k.”.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12870, datë 26.12.2012, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Shfuqizimin e markës B-52 me nr. regjistrimi 970878 me pronar shoqëria “Bavaria” n.v. Regjistrimin e vendimit të shfuqizimit në regjistrin e markave të Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave Tiranë. Rrëzimin e kundërpadiës.”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1692, datë 5.9.2013. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-755 (66), datë 9.3.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1692, datë 5.9.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Në vitin 2011 kërkesja ka bërë, një tjetër regjistrim ndërkombëtar të markës tregtare B-52, me logo të re. Ajo, gjithashtu, ka bërë një regjistrim ndërkombëtar me nr. 1082916, datë regjistrimi 14.6.2011 të markës tregtare B-52, me të njëjtat karakteristika të logos dhe të njëjtin klasifikim sipas klasifikimit ndërkombëtar Nice, në klasën 32, pije alkoolike dhe jo-alkoolike, pije energjike dhe pije sportive. Duke kërkuar që mbrojtja e këtij aplikimi të shtrihet edhe në Shqipëri. Në datën 21.7.2011, subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave (DPMP), ka pranuar regjistrimin përkatës.

7. Subjekti i interesuar, shoqëria “Arseni” sh.p.k., i ka drejtuar kërkesë Bordit të Apelit të DPMP-së për kundërshtimin e regjistrimit të mësipërm. Kjo kërkesë nuk është pranuar, pasi është paraqitur jashtë afatit ligjor.

8. Shoqëria “Arseni” sh.p.k., duke pretenduar se ky regjistrim pranë DPPM-së është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin dhe çregjistrimin e mbrojtjes së markës B-52 me nr. 1082916 me pronar “Bavaria” N.V., si dhe marrjen e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7121, datë 24.6.2013, ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Shfuqizimin e mbrojtjes së markës B-52, me nr. 1082916 regjistrimi, me pronar shoqëria “Bavaria” N.V. Regjistrimin e këtij vendimi shfuqizimi në Regjistrin e Markave të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj.”.

10. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1868, datë 6.5.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 7121, datë 24.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, me vendimin nr. 00-2017-2074 (112), datë 5.10.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1868, datë 6.5.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

12. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 5.2.2018 (sipas shënimit të shërbimit postar), por kërkesa ka qenë e paplotë. Në datën 14.5.2018 kanë ardhur materialet plotësuese të kërkesës. Ndërkohë prej datës 16 korrik të vitit 2018, Gjykata Kushtetuese nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për formimin dhe funksionimin e kolegjeve seleksionuese për shqyrtimin paraprak të çështjeve.

13. Me plotësimin e kuorunit të kërkuar nga neni 31, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese në datën 17.1.2020 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, por prej datës 23 mars të vitit 2018, Gjykata nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për formimin dhe funksionimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve.

14. Me plotësimin e kuorunit të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, për shqyrtimin paraprak të çështjeve nga Mbledhja e Gjyqtarëve, kjo e fundit, në datën 29.1.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet e palëve

15. **Kërkuesja** pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e cenimit të:

15.1. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë nuk u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura nga kërkuesja. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të saj lidhur me veprimet e kryera në keqbesim nga subjekti i interesuar, shoqëria “Arseni” sh.p.k. Ato nuk kanë bërë një hetim të gjithanshëm në lidhje me faktin se subjekti i interesuar, shoqëria “Arseni” sh.p.k. e ka fituar të drejtën për markën B-52 në keqbesim.

15.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi gjykatat nuk e kanë shqyrtuar dhe nuk e kanë marrë në konsideratë çështjen e keqbesimit, duke treguar njëanshmëri. Këto gjykata kanë marrë në konsideratë vetëm pretendimet e ngritura nga subjekti i interesuar, shoqëria “Arseni” sh.p.k. Gjykata e Apelit kishte detyrimin që të merrte në shqyrtim kontratën e shitjes me shumicë lidhur midis palëve në proces, si prova më e rëndësishme e çështjes në gjykim.

15.3. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj* dhe të *sigurisë juridike*, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, pasi në trupin gjykues të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë gjyqtari A.Ç., mandati i të cilit kishte përfunduar në datën 28.7.2017, pra përpara dhënies së vendimit.

16. **Subjekti i interesuar**, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), në parashtrimet e saj drejtuar Gjykatës, ka kërkuar pranimin e kërkesës, duke argumentuar se regjistrimi i markës B-52 nga shoqëria “Arseni” sh.p.k. është kryer në keqbesim, duke cenuar konkurrencën e ndershme. Edhe pse kjo shoqëri e ka fituar pronësinë mbi markën në një kohë të dytë, me anë të transferimit të pronësisë, kjo pronësi është fituar në kohën dhe kur shoqëria “Arseni” sh.p.k. kishte dijeni se marka B-52 ishte pronë e kërkueses.

17. **Subjekti i interesuar**, shoqëria “Arseni” sh.p.k., në parashtrimet e tij drejtuar Gjykatës, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar si vijon:

17.1. Në lidhje me *legjitimitin* e kërkueses, kërkuesja nuk legjitimohet për të kërkuar cenimin e parimit të *paanshmërisë* dhe *gjykatës së caktuar me ligj*, pasi nuk ka shteruar mjetet ligjore për paraqitjen e këtyre pretendimeve. Në lidhje me paanshmërinë e gjykatave të zakonshme, nuk rezulton që ajo ta ketë ngritur këtë pretendim në ankim ose në rekurs. Edhe pretendimin për gjykatën e caktuar me ligj nuk e ka ngritur gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, edhe pse paraqitja e kësaj kërkesë ishte plotësisht e mundur. Nëse këtë pretendim do ta kishte paraqitur pranë Gjykatës së Lartë, vetë kjo e fundit do të duhej të mbante një qëndrim lidhur me të.

17.2. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit* nuk është i bazuar, pasi të tria gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë marrë në shqyrtim pretendimin e kërkueses për “keqbesimin” dhe mbasi kanë vlerësuar provat dhe ligjin e zbatueshëm, janë shprehur në vendim duke arsyetuar se nuk janë në rastet e keqbesimit. Për më tepër ky pretendim i kërkueses ka të bëjë me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit nga Gjykata.

17.3. Në lidhje me cenimin e parimit të *paanshmërisë*, kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë cenimin e këtij parimi në aspektin objektiv ose subjektiv të tij, sikurse është trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ky parim.

17.4. Pretendimi për cenimin e parimit të *gjykatës së caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi mandati i gjyqtarit A.Ç. ka përfunduar pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të reja kushtetuese, të cilat i njohën atij të drejtën e qëndrimit në detyrë përtej mandatit 9-vjeçar, deri në zgjedhjen e zëvendësuesit. Nëse do të pranohej e kundërta, kjo do të sillte një kaos të natyrës civile për qindra vendime të marra nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që kanë qëndruar në detyrë sipas dispozitave të reja kushtetuese.

17.5. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkueses, Gjykata Kushtetuese nuk duhet t'i marrë në shqyrtim, pasi ato kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit, të cilat praktika e saj e konsoliduar nuk i ka konsideruar si pjesë të juridiksionit kushtetues.

III Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

18. Gjykata vë në dukje se prej datës 23 mars të vitit 2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor, të parashikuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

A. Për legjitimitimin e kërkuases

19. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë. Neni 71 i ligjit nr. 8577/2000 parashikon: “Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji.”.

20. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, llojin e pasojave negative të pësura dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

21. Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatën Kushtetuese dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

22. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës pasi të ketë shfrytëzuar në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuësi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

23. Kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit i gjykatave të zakonshme, ai i Gjykatës së Lartë, është i datës 5.10.2017, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 5.2.2018, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

24. Në lidhje me pretendimet e kërkuases, Gjykata çmon se *prima facie* ato hyjnë në juridiksionin e saj, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe do të shqyrtohen në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

25. Kërkuësja pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë cenuar standardin e arsyetimit të vendimit, pasi nuk u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura nga vetë ajo. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të saj lidhur me veprimet e kryera në keqbesim nga subjekti i interesuar, shoqëria “Arseni” sh.p.k. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur përciptazi në lidhje me këtë pretendim, pasi është ndalur vetëm te fakti i momentit kohor të regjistrimit të markës. Këto gjykata nuk kanë bërë një hetim të gjithanshëm në lidhje me faktin se subjekti i interesuar e ka fituar të drejtën për markën B-52 në keqbesim.

26. Subjekti i interesuar, DPPI-ja, ka pretenduar se regjistrimi i markës B-52 nga shoqëria “Arseni” sh.p.k. është kryer në keqbesim, duke cenuar konkurrencën e ndershme. Edhe pse kjo shoqëri e ka fituar pronësinë mbi markën në një kohë të dytë, me anë të transferimit të pronësisë, ajo është fituar në kushtet kur shoqëria “Arseni” sh.p.k. kishte dijeni se marka B-52 ishte pronë e kërkuases.

27. Subjekti i interesuar, “Arseni” sh.p.k., prapëson duke argumentuar se ky pretendim i kërkuases është i pabazuar, pasi të tria gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë marrë në shqyrtim pretendimin e ngritur prej saj për “keqbesimin” dhe mbasi kanë vlerësuar provat dhe ligjin e zbatueshëm, janë shprehur në vendim duke arsyetuar se nuk është rasti i keqbesimit. Për me tepër, ky pretendim i kërkuases ka të bëjë me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit nga Gjykata.

28. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për këtë pretendim të kërkuases nuk u arrit kuorumi i nevojshëm ligjor¹, pasi qëndrimet e gjyqtarëve u ndanë për sa i takon mënyrës se si e kanë vlerësuar gjykatat e zakonshme pretendimin e saj për keqbesimin në të drejtën e përfitimit të markës B-52 nga shoqëria “Arseni” sh.p.k. dhe nëse përgjigja e dhënë nga ato gjykata plotëson standardet e arsyetimit.

30. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar. Për rrjedhojë, në kushtet kur nuk u arrit shumica e votave në lidhje me bazueshmërinë ose jo në themel të këtij pretendimi, ai konsiderohet i rrëzuar.

B.2 Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

31. Kërkuësja pretendon se është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi gjykatat nuk e kanë shqyrtuar dhe nuk e kanë marrë fare në konsideratë çështjen e keqbesimit, duke treguar njëanshmëri. Gjykata e Apelit kishte detyrimin të merrte në shqyrtim kontratën e shitjes me shumicë lidhur midis palëve në proces, si prova më e rëndësishme e çështjes në gjykim.

32. Subjekti i interesuar, “Arseni” sh.p.k., prapëson duke argumentuar se në lidhje me këtë pretendim, kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë cenimin e këtij parimi në aspektin objektiv ose subjektiv të tij sipas jurisprudencës përkatëse të Gjykatës Kushtetuese për këtë parim.

33. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimin nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanshinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimin nr. 6, datë 2.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke

¹ Votuan për pranimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo dhe Sonila Bejtja.

Votuan për rrëzimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Vitore Tusha, Elsa Toska, Fiona Papajorgji dhe Altin Binaj.

mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se “thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje” (*shih vendimin nr. 6, datë 2.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Duke iu referuar rastit konkret, Gjykata vëren se për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve nuk rezulton që kërkuesja të ketë paraqitur ndonjë provë për të mbështetur pretendimin e saj. Për sa i përket paanshmërisë objektive, Gjykata vlerëson se edhe në këtë drejtim nuk ka vend për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve të çështjes. Në vlerësimin e Gjykatës pretendimet e kërkueses për cenim të këtij parimi nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin për njëanshmëri të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, për më tepër që kërkuesja këtë pretendim e lidh me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

36. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ajo nuk ka arritur të argumentojë cenimin e këtij parimi në aspektin objektiv ose subjektiv të tij. Për këto arsye, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkueses është i pabazuar.

B.3 Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe sigurisë juridike

37. Kërkuesja pretendon se është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe siguria juridike, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, pasi në trupin gjykues të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë gjyqtari A.Ç., mandati i të cilit kishte përfunduar në datën 28.7.2017, pra përpara dhënies së vendimit. Sipas saj, përbërja e këtij trupi gjykues binte ndesh me pikën 4 të nenit 179 të Kushtetutës.

38. Subjekti i interesuar, “Arseni” sh.p.k., prapëson duke argumentuar se ky pretendim i kërkueses është i pabazuar, pasi mandati i gjyqtarit A.Ç. ka përfunduar pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të reja kushtetuese, të cilat i njohën atij të drejtën të qëndrojë në detyrë përtej mandatit 9-vjeçar, deri në zgjedhjen e zëvendësuesit. Sipas tij, nëse do të pranohej e kundërta, kjo do të sillte kaos të natyrës civile në qindra vendime të marra nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që kanë qëndruar në detyrë në përputhje me dispozitat e reja kushtetuese.

39. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Ky parim në jurisprudencën kushtetuese është trajtuar i lidhur me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi, të cilat duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre, gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. Gjithashtu, këtë parim Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimet nr. 2, datë 29.1.2016; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Po, ashtu, kjo gjykatë ka theksuar se një gjykatë e caktuar me ligj duhet të plotësojë një sërë kushtesh, si mënyra e emërimit të anëtarëve, kohëzgjatja e funksionit të tyre, apo edhe ekzistenca e garancive procedurale (*shih vendimin nr. 20, datë 9.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Edhe GJEDNJ-ja në praktikën e saj ka theksuar se parimi i gjykatës së caktuar me ligj, i parashikuar në nenin 6, pika 1, të KEDNJ-së, përfshin në vetvete edhe elementin e gjyqtarit të ligjshëm, çka do të thotë se një organ gjyqësor duhet të krijohet në përputhje me vullnetin e ligjvënësit. Gjithashtu, sipas GJEDNJ-së, një gjykatë duhet të formohet në përputhje me legjisllacionin për krijimin dhe kompetencat e organeve gjyqësore, si dhe me çdo dispozitë tjetër të legjisllacionit të brendshëm, mosrespektimi i të cilave bën që pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e çështjes të jetë jo e rregullt. Bëhet fjalë pikërisht për dispozitat që lidhen me mandatet, me papajtueshmërinë në ushtrimin e detyrës së gjyqtarëve, si dhe me përjashtimin e gjyqtarëve nga shqyrtimi i një çështjeje. Parimi i gjyqtarit të ligjshëm kërkon që të

respektohen dispozitat që rregullojnë procedurën e emërimit të gjyqtarëve (*shih vendimin Gudmundur Andri Astradsson kundër Islandës, datë 12 mars 2019, §§ 71-74*). Po ashtu, kjo gjykatë i ka konsideruar si shkelje të standardit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj rastet kur nuk janë respektuar afatet e qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve (*shih vendimin Gurov kundër Moldovës, aplikimi nr. 36455/02, §§.35-39*).

41. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se mandati i gjyqtarit A.Ç., që ka marrë pjesë në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Lartë, ka filluar në datën 28.7.2008. Neni 136 i Kushtetutës, i cili ishte në fuqi në atë kohë, parashikonte: “1. Anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. 3. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi.”.

42. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, të bëra me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, në nenin 136 të Kushtetutës u shtua pika 5, e cila ka të bëjë me parashikimin e rregullit të vazhdimësisë së mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Aktualisht, neni 136, pika 5, i Kushtetutës parashikon shprehimisht, se: “*gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nën paragrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”*”.

43. Nga ana tjetër, me dispozitat kalimtare të Kushtetutës, konkretisht pikat 1 dhe 4 të nenit 179 të saj, është synuar të rregullohet periudha kalimtare e krijuar për shkak të ndryshimit të formulës dhe procedurës së përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të këtyre gjykatave, duke sanksionuar jo vetëm parimin e vazhdimësisë së mandatit kushtetues dhe të ndalimit të kufizimit apo ndërprerjes së mandatit të mëparshëm, por duke përcaktuar edhe zbatueshmërinë e procedurave të reja të emërimit vetëm për gjyqtarët e zgjedhur pas hyrjes në fuqi të dispozitave kushtetuese. Më konkretisht, pika 4 e nenit 179 të Kushtetutës parashikon: “*Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji*”. Kjo dispozitë nuk ndërhyr në përmbajtjen e nenit 136, pika 1, të Kushtetutës, i cili përcakton mandatin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, dhe nga mënyra se si është formuluar ajo nuk përjashton as efektet e rregullimit të ri kushtetues të vazhdimësisë së detyrës së tij deri në emërimin e pasardhësit, sipas parashikimit të nenit 136, pika 5, të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se fryma që përshkon Kushtetutën, edhe pas ndryshimeve kushtetuese, është vazhdimësia institucionale dhe ushtrimi i funksioneve, me qëllim garantimin e vlerave dhe parimeve që qëndrojnë në themel të shtetit të së drejtës dhe se qëllimi i përmbajtjes së nenit 179, pika 4 është që në respektim të parimit të vazhdimësisë së detyrës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të vijojë normalisht veprimtaria e këtij organi kushtetues (*shih vendimin nr. 34, datë 10.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Për sa më sipër, Gjykata vëren se mandati i gjyqtarit A.Ç. ka përfunduar pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të reja kushtetuese, të cilat parashikojnë të drejtën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë të qëndrojë në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij. Për rrjedhojë, pjesëmarrja e këtij gjyqtari në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkuar në Gjykatën e Lartë, ka qenë në përputhje me dispozitat kushtetuese në fuqi.

45. Në vështrim të kësaj analize, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuar për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nuk është i bazuar.

46. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuar nuk janë të bazuara dhe kërkesa e saj duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit

nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.3.2021.

Shpallur më 9.4.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë pro: Fiona Papajorgji, Përparim Kalo, Altin Binaj, Elsa Toska

Anëtare pjesërisht kundër: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin e ankimit individual kushtetues të paraqitur nga shoqëria “Bavaria” N.V., me objekt: *“Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 7121, datë 24.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1868, datë 6.5.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-2074(112), datë 5.10.2017, të Gjykatës së Lartë”*, votojmë pjesërisht kundër mënyrës së zgjidhjes së çështjes nga shumica, pasi vlerësojmë se kërkesa nuk duhej rrëzuar tërësisht.

2. Në respekt të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës, që parashikon publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë pjesërisht kundër.

3. Kërkuuesja, ndër të tjera, pretendon se çështja e saj nuk është gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi në përbërje të trupit gjykues ka marrë pjesë një gjyqtar me mandat të përfunduar.

4. Nga pikëpamja e fakteve duhet evidentuar se pretendimi i kërkueses lidhet me pjesëmarrjen e gjyqtarit A.Ç. në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Ai ka filluar funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë mandatin me vendimin nr. 207, datë 28.7.2008, të Kuvendit të Shqipërisë. Në datën 29.6.2017, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 5, ka deklaruar përfundimin e mandatit 9-vjeçar të gjyqtarit A.Ç. Gjyqtari në fjalë ka vijuar të qëndrojë në detyrë dhe ka qenë pjesë e trupës gjykuese prej tre gjyqtarësh të Gjykatës së Lartë, që ka shqyrtuar dhe ka dhënë vendimin nr. 2017-2074(112), datë 5.10.2017, objekt kundërshtimi në këtë gjykim kushtetues.

5. Ne ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për përmbajtjen e standardit të gjykatës së caktuar me ligj, siç është zhvilluar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ashtu siç parashtron shumica, gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj, është element i procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, që lidhet edhe me përbërjen e trupit gjykues të caktuar për shqyrtimin e çdo çështjeje gjyqësore konkrete. Gjykata e caktuar me ligj duhet të plotësojë një sërë kushtesh, ndër të cilat përfshihet edhe kohëzgjatja e funksionit të gjyqtarit në përbërje të trupit gjykues. Kur nuk respektohet afati i qëndrimit në detyrë të gjyqtarit, atëherë ka shkelje të standardit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj (*shih §§ 39-40 të vendimit*).

6. Ajo që na ndan nga qëndrimi i shumicës lidhet me *“veprimin në kohë të normave kushtetuese”* që rregullojnë kohëzgjatjen e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë ndryshuar në vitin 2016, duke krijuar një regjim tranzitor për gjyqtarët në detyrë në kohën e hyrjes në fuqi të tyre.

7. Në vitin 2008, që përkon me kohën e marrjes së mandatit të gjyqtarit A.Ç., pika 3, neni 136 i Kushtetutës parashikonte se gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Kjo dispozitë është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka theksuar se mandati kushtetues i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nuk mund të zgjatet me ligj përtej afatit të parashikuar nga Kushtetuta. Ligji nuk mund të parashikojë zgjatjen e mandatit kushtetues 9-vjeçar të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës. Pretendimi që mandati mund të zgjatet me ligj për të siguruar funksionimin normal dhe vazhdimësinë institucionale të Gjykatës së Lartë në rast krijimi të vendeve vakante, për shkak të natyrës kolegjiale të këtij organi, është haptazi i pabazuar (*shih vendimin nr. 55, datë 27.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese, §§ 15-20*).

8.. Në datën 22.7.2016, kohë në të cilën mandati 9-vjeçar i gjyqtarit A.Ç. nuk kishte përfunduar ende, Kuvendi, me ligjin nr. 76/2016, miratoi ndryshimet kushtetuese, të cilat hynë në fuqi në datën 11.8.2016. Në nenin 136, pikat 1 dhe 5 të Kushtetutës, pas ndryshimeve, parashikohet se gjyqtari i Gjykatës së Lartë emërohet për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi dhe qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit. Në të njëjtën linjë është edhe neni 139, pika 1, shkronja “c”, i Kushtetutës, sipas të cilit mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron kur përfundon mandati 9-vjeçar për të cilin është emëruar.

9. Siç konstatohet lehtësisht, në nivel kushtetues, kohëzgjatja e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ka ndryshuar vetëm për qëndrimin e tij në detyrë pas përfundimit të mandatit 9-vjeçar, ku rregulli kushtetues për ndërprerjen e menjëhershme të detyrës është ndryshuar në qëndrimin deri në emërimin e pasardhësit. Mandati 9-vjeçar dhe ndalimi i riemërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nuk pësuan asnjë ndryshim kushtetues.

10. Gjithashtu, ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 përmbanin edhe dispozitat përkatëse kalimtare, të cilat në parim janë norma me karakter të jashtëzakonshëm, që shtrëjnë në zbatimin e tyre dhe që kanë si funksion të garantojnë kalimin nga rregullimet kushtetuese të mëparshme te rregullimet aktuale. Dispozitat kalimtare të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 gjenden në nenin 179 të Kushtetutës, ku përfshihen edhe rregullat për kohëzgjatjen e funksionit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në detyrë në kohën e hyrjes në fuqi të tyre. Konkretisht, në pikën 4 të nenit 179 të Kushtetutës është përcaktuar se anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm dhe se anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji (duke kuptuar me konceptin “ligj” aktin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese).

11. Në kushtet kur kohëzgjatja e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, në përcaktimin e ri kushtetues, ka ndryshuar vetëm në lidhje me qëndrimin e tij në detyrë pas përfundimit të mandatit 9-vjeçar, atëherë është e qartë se rregulli kalimtar “*vazhdim i detyrës sipas mandatit të mëparshëm*” i referohet vetëm ushtrimit të funksionit pas mbarimit të mandatit, që sipas rregullave kushtetuese të mëparshme përfundonte në mënyrë të menjëhershme, pa pritur emërimin e gjyqtarit pasardhës. Të kuptuarit e normës kushtetuese në këtë mënyrë konfirmohet edhe nga teksti i mbetur i nenit 179, pika 4, të Kushtetutës, i cili kur u referohet anëtarëve të rinj zëvendësues të Gjykatës së Lartë, përcakton se zbatohen ndryshimet e reja kushtetuese. Për këtë kategori gjyqtarësh të rinj, dispozita kushtetuese nuk përdor më konceptin “*sipas mandatit*”, por e zgjeron fushën e veprimit të normës kushtetuese përtej kohëzgjatjes së funksionit, me konceptin “*emërohen sipas ndryshimeve të reja kushtetuese*”. Thënë ndryshe, janë pikërisht gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të emëruar pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, ndaj të cilëve zbatohen rregullat e reja kushtetuese të nenit 136 të Kushtetutës, që lidhen me formulën e re kushtetuese të emërimit dhe qëndrimin në detyrë deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës.

12. Një kuptim i ndryshëm nga ai më lart, i rregullit kalimtar “*vazhdim i detyrës sipas mandatit të mëparshëm*”, pra sikur ai përfshin vazhdimin e detyrës nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës, i jep natyrë parazitare shprehjes “*sipas mandatit të mëparshëm*”, pasi ajo mbetet pa asnjë shkak që ta mbështesë atë. Jo vetëm kaq, por një kuptim i ndryshëm e

transformon në thelb këtë rregull kalimtar, duke i dhënë atij funksionin e një norme që krijon efekte prapavepruese të ndryshimeve kushtetuese lidhur me kohëqëndrimin në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

13. Shumica ka konkluduar se pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nuk është i bazuar, pasi *“mandati i gjyqtarit A.Ç. ka përfunduar pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të reja kushtetuese, të cilat parashikojnë të drejtën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë të qëndrojë në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij. Për rrjedhojë, pjesëmarrja e këtij gjyqtari në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkuar në Gjykatën e Lartë, ka qenë në përputhje me dispozitat kushtetuese në fuqi”* (shih § 44 të vendimit).

14. Në argumentet e saj, lidhur me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, duke bërë një interpretim të zgjeruar (*in sensu latu*) të nenit 179, pikat 1 dhe 4 të Kushtetutës, shumica arsyeton se periudha kalimtare e ndryshimeve kushtetuese është rregulluar, duke sanksionuar jo vetëm parimin e vazhdimësisë së mandatit kushtetues dhe të ndalimit të kufizimit apo ndërprerjes së mandatit të mëparshëm, por duke përcaktuar edhe zbatueshmërinë e procedurave të reja të emërimit vetëm për gjyqtarët e zgjedhur pas hyrjes në fuqi të dispozitave kushtetuese. Pika 4 e nenit 179 nuk ndërhyr në përmbajtjen e nenit 136, pika 1, të Kushtetutës dhe as nuk përjashton efektet e rregullimit të ri kushtetues të vazhdimësisë së detyrës së tij deri në emërimin e pasardhësit, sipas nenit 136, pika 5, të Kushtetutës. Fryma që përshkon Kushtetutën, edhe pas ndryshimeve kushtetuese është vazhdimësia institucionale dhe ushtrimi i funksioneve, me qëllim garantimin e vlerave dhe parimeve që qëndrojnë në themel të shtetit të së drejtës dhe se qëllimi i përmbajtjes së nenit 179, pika 4 është që në respektim të parimit të vazhdimësisë së detyrës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të vijojë normalisht veprimtaria e këtij organi kushtetues (shih § 44 të vendimit).

15. Ndryshe nga shumica, ne anëtarët në pakicë jemi të mendimit se pika 4 e nenit 179 të Kushtetutës ka pasur tjetër qëllim. Sipas nesh, kjo dispozitë ka parashikuar deklarin e përfundimit të mandatit të gjyqtarëve, të cilët ushtronin detyrën në atë moment në Gjykatën e Lartë, sipas periudhës 9-vjeçare, për të cilën ata ishin zgjedhur në atë detyrë dhe pa qëndruar më tepër në detyrë, pra nuk ka parashikuar zgjatjen e qëndrimit të tyre në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj. Thënë ndryshe, në këtë dispozitë Kushtetuta nuk ka parashikuar që anëtarët, të cilët ushtronin detyrën në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, mund ta ushtronin atë pas përfundimit të mandatit 9-vjeçar deri në zgjedhjen e anëtarëve zëvendësues, siç vlerëson shumica.

16. Qëndrimin në detyrë deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës Kushtetuta e ka përcaktuar në pikën 5 të nenit 136 të saj, ku është shprehur se gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, por kjo dispozitë është e zbatueshme për anëtarët e rinj të Gjykatës së Lartë, të emëruar sipas ndryshimeve të reja kushtetuese, pas hyrjes në fuqi të tyre. Për këtë arsye, Kushtetuta, në regjimin kalimtar të ndryshimeve kushtetuese, ka theksuar, në fjalinë e dytë të pikës 4 të nenit 179 të saj, se anëtarët e rinj emërohen sipas dispozitave të reja. Fjala “i mëparshëm”, e përdorur në pikën 4 të nenit 179 të Kushtetutës, ka theksuar faktin se gjyqtarët të cilët ushtronin mandatin në atë gjykatë, do të vazhdonin ta ushtronin atë deri në përfundim të atij mandati, pra sipas rregullave kushtetuese të mëparshme.

17. Ne jemi kundër vlerësimit të shumicës, e cila interpreton në mënyrë të zgjeruar nenin 179, pika 4, të Kushtetutës dhe thekson se parimi frymëzues i interpretimit të saj është ai i vazhdimësisë institucionale, me referencë të vendimi nr. 34, datë 10.4.2017, i Gjykatës Kushtetuese. Ne vlerësojmë se pika 4 e nenit 179 të Kushtetutës duhet interpretuar në mënyrë strikte (*in strictu sensu*), duke marrë shkas nga vetë jurisprudenca kushtetuese, e lidhur saktësisht me kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë pas mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë sipas regjimit të mëparshëm kushtetues, e cila nuk e ka përkrahur parimin e vazhdimësisë institucionale për këtë çështje (shih vendimin nr. 55, datë 27.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese, §§ 15-20). Gjithashtu, sipas mendimit tonë, referimi i shumicës në vendimin nr. 34, datë 10.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese nuk është i përshtatshëm për çështjen konkrete, pasi në atë vendim parimi i vazhdimësisë

institucionale është vlerësuar se përshkon rregullat kalimtare të ndryshimeve kushtetuese, por konteksti i mosmarrëveshjes kushtetuese në atë gjykim ka qenë i ndryshëm. Konkretisht, ky parim është vlerësuar në kuadrin e analizës së kalimit të kompetencave nga organet që u suprimuan tek organet e reja, të krijuara për herë të parë nga ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, si dhe në kuadrin e vlerësimit të një ligji që përfundonte para kohe mandatin e gjyqtarëve, duke përfshirë edhe atë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Kjo tregon se parimi i vazhdimësisë institucionale është vënë në dukje nga Gjykata Kushtetuese për të mos lejuar mungesa të ushtrimit të funksioneve shtetërore ose përfundim të mandateve para kohe në tejkalim të normave kushtetuese, qofshin ato të regjimit të mëparshëm ose të regjimit të ri kushtetues.

18. Rrjedhimisht, në ndryshim nga shumica, ne çmojmë se parimi i vazhdimësisë institucionale nuk mund të përdoret për t'u dhënë dispozitave kushtetuese efekt prapaveprues, sepse ky lloj efekti mund të jepet vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë nga normat kushtetuese.

19. Për sa më sipër, vlerësojmë se Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës për pjesën që lidhjet me këtë pretendim, pasi çështja e kërkuarës nuk është gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, në kushtet kur mandati i njërit prej anëtarëve të trupit gjykues, në kohën e vendimmarrjes, kishte përfunduar. Në përfundim të këtij përfundimi, hedhin dritë edhe faktet konkrete të çështjes: i) gjyqtarit i kishte përfunduar mandati kushtetues në datën 28.7.2017; ii) ai ka vijuar të qëndrojë në detyrë edhe përtej këtij afati; iii) megjithatë, gjyqtari de facto nuk qëndroi në detyrë deri në zëvendësimin nga gjyqtari pasardhës, por menjëherë pas vendimmarrjes për çështjen konkrete të datës 5.10.2017, ditën vijuese, më 6.10.2017, ka dorëzuar detyrën; iv) trupi gjykues i Gjykatës së Lartë përbëhej nga 3 anëtarë dhe u nda në votim (dy me një), ku gjyqtari A. Ç. ishte pjesë e shumicës prej dy gjyqtarësh, që dëshmon se në dhënien e vendimit jo unanim, pjesëmarrja në gjykim e tij, pa mandat, ishte përcaktuese në vlefshmërinë e vendimit gjyqësor.

20. Për sa më lart, nuk kemi asnjë dilemë të pohojmë se mandati i gjyqtarit A.Ç., për mendimin tonë dhe në interpretim in *strictu sensu* të nenit 179, pika 4, të Kushtetutës, në kohën e vendimmarrjes për çështjen konkrete, konsiderohet një mandat i përfunduar. Rrjedhimisht, ashtu siç ka pohuar GJEDNJ-ja, përfundimi i mandatit konsiderohet se për pjesëmarrjen në gjykim të gjyqtarit nuk ka një bazë ligjore. Praktika e ripërtëritjes në mënyrë të heshtur të mandatit të gjyqtarëve për një kohë të papërcaktuar konsiderohet shkelje e parimit të “gjykatës së caktuar me ligj” (shih *Poskehov k. Federata Ruse, 2003, §§ 39-44; Oleksandr Volkov k. Ukrainës, 2013, § 151; Gurov k. Moldavisë, 2006, §§ 37-39*).

21. Gjithashtu, duhet të theksojmë se në gjyqtarët e pakicës e kemi vlerësuar se ekziston një lidhje shkakësore midis “mandatit të përfunduar” dhe pretendimit tjetër të kërkuarës për “cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë”, pretendim për të cilin nuk u arritën votat e duhura për marrjen e vendimit dhe, rrjedhimisht, as për përpilimin e një mendimi pakice.

Shpallur më 9.4.2021.

Anëtare: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja